



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr. 111/01-24655 /2017
Kaçanik, 27.07.2017

Në bazë të nenit 5 pika(c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 Për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, shpallë:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta të Komunës së Kaçanikut për vitin shkollor 2017/2018.

1. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Emin Duraku” në Kaçanik:

Një mësimdhënësi i lëndës; Gjuhë Angleze, zëvendësim (pushim i lehonisë).
Një mësimdhënësi i lëndës; Gjuhë Gjermane, me 7 orë, me plotësim norme në Gjimnazin “Skënderbeu” dhe SHMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” Kaçanik.

• **Paralelja e ndarë fizike në Gjurgjedell:**

Dy mësimdhënësi të mësimit klasor me klasë të kombinuara dhe
Një mësimdhënësi i lëndës; Gjuhë Angleze, me plotësim norme në Llanishtë.

• **Paralelja e ndarë fizike në Kërbliq:**

Një mësimdhënësi i mësimit klasor me klasë të kombinuara.

• **Paralelja e ndarë fizike në Llanishtë:**

Një mësimdhënësi i mësimit klasor me klasë të kombinuara.

2. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Nazmi Osmani” në Elezaj:

Një mësimdhënësi i lëndës; Gjuhë Angleze, zëvendësim (pushim i lehonisë).

3. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Dituria” në Ivajë:

Një mësimdhënësi i mësimit klasor dhe
Një mësimdhënësi i mësimit klasor, zëvendësim (pushim i lehonisë).

• **Paralelja e ndarë fizike në Strazhë:**

Dy mësimdhënësi të mësimit klasor me klasë të kombinuara, dhe
Një mësimdhënësi i lëndës; Edukatë Muzikore, Ivajë – Strazhë, me 6 orë.

4. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Naim Frashëri” në Kotlinë:

Një Edukatore dhe
Një mësimdhënësi i lëndës; Gjuhë Angleze, me 9 orë, me kohë të caktuar.

5. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Qamil Ilazi” në Kaçanik i Vjetër:

Një mësimdhënësi i lëndës; Gjuhë Gjermane, me 9 orë.

6. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Gafurr Luma” në Gllobocicë:

Një mësimdhënësi i mësimit klasor.

7. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Agim Bajrami” në Stagovë:

Një mësimdhënësi i mësimit klasor.

8. Shkolla e Mesme Profesionale “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”-Kaçanik:

Katër mësimdhënësi të lëndës; Matematikë njëri me 13 orë,
Një mësimdhënësi i lëndës; Teknologji – Informatikë, me plotësim norme në Gjimnazin “Skënderbeu” Kaçanik.

9. Gjimnazi "Skënderbeu" në Kaçanik:

Dy mësimdhënës të lëndës; Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, njëri me 15 orë dhe
Një mësimdhënës i lëndës; Fizikë me 15 orë.

Kushtet e Konkursit:

Për vendet e punës të shënuar më lartë, kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it.Nr.06/2015 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Të drejtë aplikimi në konkurs kanë kandidatët e degës përkatëse.

Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin si në vijim:

- diploma e fakultetit përkatës,
- ekstrakti i lindjes dhe
- kopjen e letërnjoftimit.

Të gjitha dokumentet gjatë aplikimit duhet të jenë kopje, ndërsa origjinali duhet të sjellet në ditën e intervistimit.

Afati dhe mënyra aplikimit.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar -Zyra e pranimit, kati përdhësë dhe në web-faqen komunale.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes tabelës së shpalljeve publike.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik prej 28.07.2017 deri 11.08.2017.

